

apo nën jastëqet e tyre për t'u mbrojtur prej të marrurit mësysh, shqetësimit, apo për të sjellë dashurinë e burrit e të ngjashme.

3. Ajo e cila njihet si unaza e fejesës, pasi përveç asaj që ajo është e marrur nga të krishterët ajo gjithashtu mund të jetë prej shtigjeve të shirkut kur besohet se ajo është që bashkon emrat e dy të martuarve.

4. Vizatimet që varen në vetura, rruaza e të ngjashme për të larguar syrin e keq.

5. Ajo e cila njihet te futbollistët, të cilët e vendosin te parakrahu një nbështjellëse të caktuar ose e varin nëpër dritare, duke pretenduar se kjo ua sjell fitoren. Bile, ndoshta ajo që varet përmban ajete nga Kurani dhe ata vendosin nën këpucët e tyre.

Përktheu: Driton Lekaj

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



Allahu thotë:

"Vallë në vendin Tim do ta merrni për mik atë (shejtanin) dhe pasardhësit e tij, ndërkohë që ata janë armiq të tuaj? Sa këmbim i shëmtuar është ai që bëjnë jobesimtarët!" (Kehf, 50).

"Shejtani është armiku juaj, ndaj edhe ju konsiderojeni atë si armik, ai e thërret grupin e tij vetëm se për t'i bërë banues të zjarrit." (Fatir, 6).

Zoti na dhëntë fuqi për t'i kaluar këto ditë dhe netë të begata me namaz nate, dua, dhikër, lexim Kurani dhe adhurime të tjera!

Përgatiti: Erion Sula

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



Hajmali quhen ato gjëra që varen në qafë, mjete bartëse, shtëpi apo diku tjetër për të sjellë dobi apo shmangur dëm, qofshin ato nga Kur'ani, nga penjtë, rruazat, guralecët e të tjerë.

Emërtime të tjera të hajmalive:

1. Huruz (ato që ruajnë),
2. Huxhub (ato që mbrojnë).
3. Teaik (ato që varen).
4. Uedeah (ato që sjellin rehati e pushim).

Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) thotë: *“Ai e cili e varë një hajmali mos ia plotësoftë Allahu atë për të cilën e ka varur dhe ai që e varë një edeah mos i dhëntë qetësi e rehati!”* (Transmeton Ahmedi, Hakimi, i cili e konsideron si të saktë dhe me të pajtohet edhe Dhehebiu)

SHKAQET E NDALIMIT TË TYRE

1. Varësia e zemrës me dikë tjetër përveç Allahut, subhanehu ve teala.
2. Ato nuk janë as shkaqe islame e as të natyrshme (të dukshme) që ndihmojnë, e bindja se ato janë shkaqe është ligjësimit me Allahun dhe kundërshtim në krijimin dhe urdhërin e Tij.
3. Ato i hapin njeriut dyert e bestytnive dhe e shpien drejt shirkut.
4. Janë shkak i humbjes, pasi ai që lidhet me diçka do t'i mbështetet atij.

Allahu i Madhëruar na ka zgjedhur dhjetë netë nga më të begatat që eksiztojnë. Begatia në to është e përmasave madhështore. Këto netë kanë vlera të mëdha, ndër të cilat do të përmendim se Pejgamberi (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) në këto netë e shtonte së tepërmi adhurimin dhe punët e mira.

Transmetohet nga Aishja se: *“Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) i shtonte punët e mira në këto netë jo si në çdo natë tjetër.”* (Transmeton Muslimi).

Ajo thotë: *“Kur hynte dhjetëditëshi i fundit i Ramazanit Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) shtrëngonte izarin, falte namaz gjithë natën dhe për këtë zgjonte edhe pjestarët e familjes”*. Transmeton Buhari.

Ajo thotë gjithashtu: *“Pejgamberi e përziante, njëzetëditëshin e fundit me namaz nate dhe me gjumë, por kur hynte dhjetëditëshi, nuk flinte por shtrëngonte izarin”*. (Transmeton Ahmedi).

Nëpërmjet këtyre haditheve del në pah vlera e këtyre netëve, sepse edhe Pejgamberi (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) u ka kushtuar rëndësi atyre duke shtuar në këto netë punët e mira. Ai rrinte tërë natën zgjuar duke falur namaz, duke lexuar Kur'an e duke bërë dhikër. Këtë e bënte për madhësinë dhe rëndësinë e këtyre ditëve dhe për të kërkuar *Natën e Kadrit*, në të cilën kush falet me besim dhe duke llogaritur sevapin, i falen të gjitha gjynahet e

A JANË HAJMALITË PREJ SHIRKUT TË VOGËL APO TË MADH?

1. Nëse hajmalia është idhull, lexim (rukje) e idhujtarëve apo kryq, atëherë ky është shirk i madh, pa dyshim.
2. Nëse është prej penjëve, rruazave e të ngjashme e mbështetet në to plotësisht dhe bindet se ato ndikojnë të pavarura, ky gjithashtu është shirk i madh.
3. Nëse është prej penjëve, rruazave e të ngjashme dhe beson se ato janë vetëm shkaqe e nuk mbështetet në to plotësisht, ky është shirk i vogël.

DISPOZITA PËR HAJMALITË NË TË CILAT GJENDEN PJESË NGA KURANI APO SUNETI

Mendimi më i saktë është se nuk lejohen për shkaqet e mëposhtme:

1. Për t'i mbyllur rrugët që shpien në shirk.
2. Për shak se ndalesa për hajmalitë është e përgjithshme.
3. Ndoshta kjo shpie në përbuzjen e Kuranit dhe lutjeve pejgamberike. Kjo duket duke i hyrë me to në banjo dhe duke ia eksponuar ato ndyrësirave.
4. Është shkak që keqbërësit shkruajnë një ajet, sure apo bismilahun e më poshtë shënojnë simbole djallëzore dhe fjalë ndihmëkërkuese me karakter idhujtar.
5. Ndoshta bëhet shkak që të lihet anash Kurani dhe lutjet (duaaja) dhe mjaftohen me atë që është varur.

SHEMBUJ TË HAJMALIVE PREZENTE

1. Ajo e cila u varet fëmijëve nga frika prej të marrurit mësysh.
2. Atë që e marrin disa gra dhe e vendosin në domat e tyre

mëparshme. Mënyra se si Pejgamberi (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) i shfrytëzonte këto ditë, me namaz, dhikër e adhurim, tregon se ato janë një rast i volitshëm, ato janë një mundësi për të gjithë dhe fushatë e begatë për atë të cilit Allahu ia ka lehtësuar.

Ndaj edhe besimtari i mençur nuk e lë këtë rast t'i shpëtojë, si atij ashtu edhe familjes së tij. Ato janë disa netë të pakta, mund të ndodhë që gjatë adhurimit në këto netë të ndiesh shijen e pendimit dhe sinqeritetit, e kështu fiton dynjanë dhe ahiretin. Është për të ardhur keq kur shikon se si shumë prej muslimanëve, këto netë të begata i kalojnë me gjëra që nuk u bëjnë dobi. Rrinë deri natën vonë duke bërë muhabet, dhe kur vjen koha për të falur namaz nate, flenë duke u shpëtuar në këtë formë një shpërblim mjaft i madh, të cilin nuk mund ta gjejnë më gjatë atij viti. Nuk ka dyshim se ata i vë në lojë shejtani, i cili është betuar të largojë njerëzit nga bindja e Allahut të Madhëruar.

Allahu i madhëruar i thotë shejtanit të mallkuar:

“Sepse ti ndaj robërve të Mi (të sinqertë) nuk ke kurrfarë force (as fizike e as mendore), përveç atyre të humburve që të vijnë nga pas.” (Hixhër, 42).

Ai që është i mençur nuk e ndjek rrugën e shejtanit i cili i ka dalë si kundërshtar i Allahut, kjo është në kundërshtim me logjikën e shëndoshë.